Sjelljet ndihmë kërkuese të grave që përjetojnë dhunë në Shqipëri



Suedi
Sverige

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

UNITED NATIONS
ALBANIA

UNDP
Empowered lives.
Resilient nations.

PËRMBLEDHJE STUDIMI[1]

Sjelljet ndihmë kërkuese të grave që përjetojnë dhunë në Shqipëri

Qershor 2019

1. *Ky vrojtim u krye nga INSTAT, me ekspertizën teknike të ofruar dhe shkrimin e raportit të kryesuar nga Dr. Robin Haarr, konsulente ndërkombëtare, me mbështetjen e UNDP-së dhe UN Women dhe me ndihmën financiare të Qeverisë së Australisë, në kuadër të projektit rajonal për statistikat gjinore dhe të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm "Të bëjmë çdo grua dhe vajzë të ketë rëndësi", dhe të Qeverisë Suedeze, në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara "T'i japim fund Dhunës ndaj Grave në Shqipëri". Opinionet dhe mendimet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht mendimet e UNDP-së, UN Women dhe/ose të donatorëve të tyre.*



HYRJE

Ekziston një mungesë e studimeve mbi sjelljet ndihmë kërkuese të grave që përjetojnë dhunë në Shqipëri.

Dhuna ndaj Grave (DhNG) është një shkelje e përhapur e të drejtave të njeriut dhe një problem global i shëndetit publik me përmasa epidemike. DhNG-ja pranohet edhe si shkak edhe si pasojë e pabarazisë gjinore dhe është një pengesë kryesore që gratë dhe vajzat të gëzojnë të drejtat e njeriut dhe që ato të marrin plotësisht pjesë në shoqëri dhe ekonomi. Nuk ka një faktor të vetëm që shkakton DhNG-në; përkundrazi, ka disa elementë që veprojnë në nivele të ndryshme të "ekologjisë sociale", të cilët përjetësojnë dhe përforcojnë qëndrimet, normat dhe praktikat diskriminuese dhe paragjykuese gjinore, të cilat kontribuojnë në pabarazinë e përhapur të pushtetit mes burrave dhe grave në shoqëri dhe në DhNG.
DhNG-ja shfaqet në forma të ndryshme të dhunës fizike, seksuale, psikologjike dhe ekonomike, e cila ndodh në hapësira publike dhe private. DhNG-ja shkatërron shëndetin mendor dhe fizik si edhe mirëqenien e grave e vajzave dhe mund të ketë një efekt negativ në sigurinë, stabilitetin dhe paqen e tyre afatgjatë. DhNG-ja ka gjithashtu ndikim serioz në zhvillimin dhe avancimin e grave si edhe në kontributin që ato japin në ekonomi. DhNG-ja nuk është një fenomen i ri në Shqipëri. Ajo i ka rrënjët thellë në traditat dhe zakonet patriarkale të cilat i kanë dhënë formë Shqipërisë prej kohësh, përfshirë identitetet dhe rolet e ngurta gjinore, autoritetin patriarkal, respektimin e sistemit të nderit dhe turpit, zakonet e urdhrave hierarkike brenda familjes si edhe kontrollin midis brezave në familje.

Me asistencën teknike dhe mbështetjen e UNDP-së dhe UNICEF-it, INSTAT kreu Vrojtimin e parë Kombëtar për Dhunën në Familje (VKDhF) në vitin 2007. Në vitin 2013, me asistencë teknike nga UNDP-ja dhe mbështetje financiare nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Sida), INSTAT kreu VKDhF-në e 2-të. Vrojtimi Kombëtar për Dhunën ndaj Grave i vitit 2018 (VKDhNG) përdori një metodologji dhe instrumente të mbledhjes së të dhënave të ngjashme me VKDhF-në e vitit 2013 për të mbledhur të dhëna të besueshme për natyrën dhe përhapjen e dhunës nga partneri intim, dhe u zgjerua më tej për të mbledhur të dhëna mbi dhunën gjatë marrëdhënies dashurore, dhunën nga jopartneri, ngacmimin seksual, përndjekjen dhe normat shoqërore që lidhen me DhNG-në.

VKDhNG-ja e vitit 2018 mblodhi të dhëna për sjelljet ndihmë kërkuese të grave që kanë përjetuar dhunë në familje nga partneri intim dhe dhunë nga jopartneri. Më konkretisht, studimi vlerësoi shkallën në të cilën gratë kërkonin ndihmë në rastet e dhunës në familje nga partneri intim dhe dhunës nga jopartneri, dhe shqyrtoi se nga kush kërkonin ndihmë gratë si dhe arsyet se pse kërkonin ose nuk kërkonin ndihmë në rastet e dhunës në familje nga partneri intim ose dhunës nga jopartneri. Ky informacion është i rëndësishëm sepse mund të ndihmojë përkrahësit e viktimave, ofruesit e shërbimeve, policinë bashkiake, oficerët e drejtësisë dhe vendimmarrësit në identifikimin e pengesave që ekzistojnë si dhe mund t'i ndihmojë ata në eliminimin e këtyre pengesave dhe në zhvillimin e ndërhyrjeve që lehtësojnë sjelljet ndihmë kërkuese nga gratë që kanë përjetuar dhunë nga partneri intim, dhunë në familje dhe forma të tjera të dhunës me bazë gjinore.

HARTIMI I STUDIMIT

VKDhNG e vitit 2018 në Shqipëri u bë për të matur natyrën dhe shkallën e pesë llojeve të ndryshme të DhNG-së – dhuna në familje e ushtruar nga partneri intim, dhuna gjatë marrëdhënies dashurore, dhuna nga jopartneri, ngacmimi seksual dhe përndjekja, si dhe sjelljet ndihmë kërkuese të grave që përjetojnë dhunë në familje nga partneri intim dhe dhunë nga jopartneri. Studimi përfshiu një vrojtim kombëtar të familjeve me bazë popullatën të kryer në secilën nga 12 prefekturat e Shqipërisë. U përdor modeli i kampionit me shtresëzim për përzgjedhjen e grave të kampioneve. Qëllimi ishte të nxirrej një kampion grash të moshës 18-74 vjeç, i cili do të bënte të mundur nxjerrjen e vlerësimeve të besueshme kombëtare statistikore për përhapjen e DhNG-së.

Kampioni i grave

Kampioni përfundimtar i grave përfshiu 3443 familje dhe gra të moshës 18-74 vjeç. Kampioni nuk u shpërnda në mënyrë të barabartë nëpër prefektura, pasi më shumë gra u intervistuan në Tiranë (27,1%), kryeqyteti i vendit, i cili ka një popullsi shumë më të madhe, dhe në Fier (11,5%) dhe Elbasan (10,6%), krahasuar me Kukësin (3,0 %) dhe Gjirokastrën (2,6%) ku janë intervistuar shumë më pak gra. Pati një shpërndarje tërësisht të barabartë të grave të intervistuara në secilën nga grupmoshat. Gratë varjonin nga mosha 18 deri në 74 vjeç, me një moshë mesatare 43,6 vjeç. Sa i përket arsimit, 42,4% e grave kishin arsim të mesëm të ulët (8-9 vjet), 27,8% kishin arsim të mesëm të lartë, dhe 19,7% kishin arsim universitar; vetëm 7,7% e grave kishin vetëm arsim fillor ose më pak.

Shumica e grave të intervistuara ishin aktualisht të martuara dhe/ose jetonin me një partner mashkull (73,3%); 20,3% aktualisht nuk ishin të martuara ose nuk jetonin me një partner mashkull. Vetëm 4,1% ishin të veja, 1,2% të divorcuara dhe 0,2% të ndara nga bashkëshorti/i dashuri i tyre aktual. Shumica e grave ishin martuar ose kishin jetuar për herë të parë me një burrë në moshën 18-24 vjeçare (63,2%).



73.3%

e grave të intervistuara ishin aktualisht të martuara dhe/ose jetonin me një partner mashkull

63.2%

e grave ishin martuar ose kishin jetuar për herë të parë me një burrë në moshën 18-24 vjeçare

SJELLJET NDIHMË KËRKUESE TË GRAVE NË RASTIN E DHUNËS NË FAMILJE NGA PARTNERI INTIM

VKDhNG-ja e vitit 2018 zbuloi se 47,0% e grave (ato që ishin apo kishin qenë të martuara dhe/ose jetonin me një partner) kishin përjetuar dhunë në familje nga partneri intim të paktën një herë gjatë jetës së tyre ("ndonjëherë"), dhe 1 në 3 ose 33,7% e grave kishin përjetuar dhunë në familje nga partneri intim gjatë 12 muajve përpara vrojtimit ("aktualisht"). Llojet e dhunës në familje nga partneri intim të përjetuara nga gratë përfshinin sjelljet kontrolluese, dhunën ekonomike, dhunën psikologjike, dhunën fizike dhe/ose dhunën seksuale nga bashkëshorti/partneri aktual dhe/ose ish-bashkëshorti/partneri. Vlen të theksohet se 21,0% e grave kanë përjetuar "ndonjëherë" dhunë fizike dhe/ose seksuale, ose të dyja dhe 8,2% e grave kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale, ose të dyja, gjatë 12 muajve përpara vrojtimit.

Shpeshherë gratë e rrahura hezitojnë të kërkojnë ndihmë për dhunën në familje. Vetëm 16,9% e grave që kishin përjetuar "aktualisht" dhunë në familje i kishin treguar dikujt për dhunën e pësuar dhe vetëm 8,4% e grave kishin kërkuar ndihmë. Gratë që përjetonin "aktualisht" dhunë fizike dhe/ose seksuale, ose të dyja, kishin dy herë më shumë gjasa t'i tregonin dikujt për dhunën (30,8%) dhe dy herë më shumë gjasa që të kërkonin ndihmë (18,5%). Këto të dhëna tregojnë peshën që ka dhuna në familje nga partneri intim në gjasat për të kërkuar ndihmë.

Nga gratë që përjetonin "aktualisht" dhunë fizike dhe që kishin përjetuar lëndime nga dhuna në familje, 23,1% u ishte dashur që të kalonin të paktën një natë në spital, megjithatë vetëm 13,4% i kishin treguar personelit shëndetësor se dhuna në familje ishte shkaku i dëmtimeve të tyre. Shpeshherë gratë nuk u tregojnë mjekëve ose infermierëve se dhuna në familje është shkaku i lëndimeve të tyre; shpesh, ato gënjejnë lidhur me shkakun e lëndimeve për të mbrojtur bashkëshortin/partnerin, si dhe nga frika, turpi dhe/ose sikleti. Në të njëjtën kohë, mjekët dhe infermierët shpesh nuk bëjnë depistim për dhunë në familje apo të pyesin gratë për shkakun e lëndimeve të tyre, veçanërisht nëse depistimi për dhunën në familje në institucionet shëndetësore nuk është i detyrueshëm.

Këto gjetje tregojnë se shumica e grave të rrahura në Shqipëri vuajnë në heshtje pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme për të rritur ndërgjegjësimin mbi problemin e dhunës në familje, ligjeve për dhunën në familje dhe shërbimeve sociale për viktimat e dhunës në familje. Për pasojë, gratë e rrahura nuk po marrin shërbimet bazë, mbrojtje dhe akses në drejtësi, të cilat janë të drejta të tyre ligjore dhe njerëzore.

Gratë e rrahura në Shqipëri vazhdojnë të vuajnë në heshtje

Vetëm 16,9% e grave që kishin përjetuar "aktualisht" dhunë në familje i kishin treguar dikujt për dhunën e pësuar dhe vetëm 8,4% kishin kërkuar ndihmë

Gratë që përjetonin "aktualisht" dhunë fizike dhe/ose seksuale, ose të dyja, kishin dy herë më shumë gjasa t'i tregonin dikujt për dhunën (30,8%) dhe dy herë më shumë gjasa që të kërkonin ndihmë (18,5%)

8.4%
E GRAVE KISHIN KËRKUAR NDIHMË

KUJT I DREJTOHEN PËR NDIHMË GRATË E RRAHURA?

Kur gratë e rrahura kërkojnë ndihmë për dhunën në familje shumica prej tyre kërkojnë ndihmë nga familja e tyre (98,9%) dhe një përqindje e konsiderueshme kërkojnë ndihmë nga familja e bashkëshortit/partnerit të tyre (40,4%). Ndonëse të pakta në numër, disa gra kërkojnë ndihmë nga rrjetet joformale të tilla si fqinjët (11,9%), miqtë (6,7%) dhe udhëheqësit fetarë (1,7%). Një numër shumë më i ulët kërkojnë ndihmë nga rrjetet formale si policia (4,4%), avokatët (3,4%), mjekët/punonjësit e shëndetësisë (3,1%), gjykatësit (2,8%), agjencitë/organizatat e shërbimeve shoqërore (1,6%) dhe/ose nga një strehë për gra dhe vajza (0,4%). Asnjë grua nuk ka kërkuar ndihmë nga shërbimi i ndihmës dhe/ose nga koordinatori lokal për dhunën në familje; kjo gjetje çon në konkluzionin se gratë ose nuk janë në dijeni të shërbimit të ndihmës dhe/ose të koordinatorëve lokalë për dhunën në familje, ose të mbijetuarat e dhunës në familje nuk kanë besim në këto rrjete formale të shërbimeve mbështetëse.

Kujt i drejtohen për ndihmë gratë e rrahura?

Familja	
Familja ime	98.0%
Familja e bashkëshortit/partnerit	40.4%
Bashkëshorti/i dashuri aktual / ish-bashkëshorti/i dashuri	4.2%
Rrjetet joformale	
Fqinjë	11.9%
Miq	6.7%
Udhëheqës fetar	1.7%
Rrjetet formale	
Policia	4.4%
Avokati	3.4%
Mjeku/punonjësi i institucioneve shëndetësore	3.1%
Gjyqtari	2.8%
Agjencia/organizata e shërbimeve shoqërore	1.6%
Strehëza për gratë dhe vajzat	0.4%
Shërbimi i ndihmës	0.0%
Koordinatori lokal për dhunën në familje	0.0%
Të tjerë	0.0%

SA INCIDENTE TË DHUNËS NË FAMILJE JANË REGJISTRUAR NË POLICINË E SHTETIT?

Gjatë viteve të fundit, është rritur interesi i Qeverisë së Shqipërisë dhe partnerëve për zhvillim për të forcuar të dhënat administrative si dhe për të monitoruar dhe raportuar dhunën në familje dhe sulmin seksual/përdhunimin. Në përputhje me këtë, mbledhja e të dhënave administrative është institucionalizuar përmes ngritjes së sistemit "Regjistrimi i dhunës në Shqipëri" (REVALB), një sistem kombëtar gjurmimi online që përdoret nga koordinatorët lokalë të dhunës në familje në çdo bashki dhe që administrohet në nivel qendror nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MShMS, ndërsa më parë menaxhohej nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë). Megjithatë ka ende vështirësi për sa i përket përdorimit sistematik të sistemit REVALB dhe garantimit të koordinimit ndërmjet anëtarëve të mekanizmit të referimit në gjurmimin dhe menaxhimin e rasteve.

Të dhënat administrative dhe të dhënat për përhapjen e DhNGV-së vijnë nga burime të ndryshme, kanë qëllime të ndryshme dhe u përgjigjen pyetjeve të ndryshme. Së bashku, të dhënat administrative dhe të dhënat për përhapjen e DhNGV-së shërbejnë për ta kuptuar më mirë këtë problem. Dallimet ndërmjet përhapjes dhe incidenteve aktuale të dhunës, pranimit dhe raportimit të dhunës variojnë por duhet të kuptohen për të vlerësuar kostot e parandalimit, reagimit dhe eliminimit të DhNGV-së, si dhe për të planifikuar dhe hartuar politika dhe programe.

Në përgjithësi, studimet mbi përhapjen e DhNGV-së mbledhin të dhëna nga një kampion përfaqësues i popullsisë (kombëtar ose lokal)

Lidhjet ndërmjet të dhënave për përhapjen e DhNGV-së dhe të dhënave administrative për DhNGV-në

Të dhënat administrative për DhNGV-në nuk mund të përdoren si zëvendësuese të të dhënave të përhapjes së DhNGV-së sepse të dhënat administrative nuk pasqyrojnë me saktësi përhapjen e DhNGV-së në popullsi.

Të dhënat administrative nuk janë përfaqësuese sepse një numër i madh i të mbijetuarave të DhNGV-së nuk e raportojnë dhunën e përjetuar te ofruesit e shërbimit ose agjencitë zyrtare.

Të dhënat për përhapjen e DhNGV-së mund të paraqesin përqindjen e grave dhe vajzave që kanë përjetuar dhunë ndërsa të dhënat administrative tregojnë se sa prej tyre kërkojnë ndihmë, cilët ofrues të shërbimit i ofrojnë ndihmë si dhe numrin e shërbimeve të nevojshme.

në mënyrë që rezultatet të përfaqësojnë përhapjen reale si dhe të japin informacione më të detajuara rreth kontekstit ku ndodh DhNGV dhe se si ndikon ajo te gratë dhe vajzat në popullsinë e përgjithshme. Studimet për përhapjen e DhNGV-së ndihmojnë në vendosjen e një baze krahasimore e cila përdoret për të krahasuar studimet e tjera, në mënyrë që të monitorohen ndryshimet në përhapjen e DhNGV-së, faktorët që kontribuojnë në DhNGV me kalimin e kohës dhe aspektet negative të saj. Të dhënat për përhapjen e DhNGV-së mblidhen në mënyrë periodike (një herë çdo disa vite) në një moment të caktuar.

Edhe pse të dhënat administrative për DhNGV-në nuk paraqesin përhapjen e këtij fenomeni, përdorimet e të dhënave administrative janë të shumta; mbi të gjitha, të dhënat administrative mund të ndihmojnë ofruesit e shërbimeve, agjencitë e drejtësisë dhe vendimmarrësit që të dinë numrin e incidenteve të dhunës në familje që raportohen dhe trajtohen, numrin e grave të rrahura që kanë akses në shërbime, shërbimet ku kanë akses, aksesin në drejtësi dhe referimet e bëra nga ofruesit e shërbimeve. Të dhënat administrative mund të zbulojnë gjithashtu modelet dhe tendencat e sjelljeve në kërkimin e ndihmës të të mbijetuarave të DhNGV-së përgjatë kohës. Në nivel praktik, të dhënat administrative mund të përdoren për të mbështetur planifikimin e përgjithshëm të programeve si dhe alokimin e burimeve me qëllim trajtimin e dhunës në familje.

Kur diskutohet rreth të dhënave administrative për dhunën në familje, është e rëndësishme të kuptohet se shumica e incidenteve të dhunës në familje nuk raportohen tek autoritetet. Shumica e grave hezitojnë të raportojnë tek autoritetet përvojat e tyre me dhunën me bazë gjinore për një sërë arsyesh, duke përfshirë: idenë se dhuna e përjetuar nuk ishte serioze; frikë nga hakmarrja (shumë gra dhe vajza kërcënohen se do të dhunohen më tepër ose vriten nëse flasin ose i tregojnë autoriteteve rreth personave ose personit që ka kryer dhunën); frikë nga turpi ose kritikat që mund të marrin në rast se tregojnë sepse nuk duan të turpërojnë familjen e tyre; dhe, mungesa e besimit te policia dhe sistemi i drejtësisë. Gjithashtu, varësia ekonomike e grave ndaj personave që i dhunojnë/rrahin, është një tjetër faktor që i pengon ato të denoncojnë ose të largohen nga situatat e dhunës në familje dhe dhunës nga partneri intim. Për më tepër, autorët mund të kenë pozicione me pushtet në komunitet dhe nuk duan që t'i zbulohet identiteti ose t'i dëmtohet reputacioni, kështu që mund të bëjnë kërcënime të besueshme për t'i mbyllur gojën grave me të cilat kanë abuzuar.

Grafiku 1. **Rastet e regjistruara të dhunës në familje nga Policia e Shtetit (2010-2018)**



Burimi: Policia e Shtetit Shqiptar, janar 2019

Grafiku 2. **Rastet e regjistruara të dhunës në familje nga Policia e Shtetit, sipas nenit 130/a të Kodit Penal (2013-2018)**



Burimi: INSTAT, janar 2019

Nëse gratë nuk i raportojnë përvojat e tyre të dhunës në familje tek autoritetet ose shërbimet zyrtare, atëherë përvojat e tyre nuk pasqyrohen në të dhënat administrative. Po ashtu, nëse punonjësit e policisë nuk i regjistrojnë incidentet e dhunës në familje, atëherë këto incidente nuk pasqyrohen në të dhënat administrative. Studimet në nivel global kanë treguar se disa punonjës policie i dekurajojnë duke fajësuar gratë e rrahura ose duke i inkurajuar ato që të kthehen dhe të pajtohen me bashkëshortin dhe familjen e tyre, në mënyrë që të mos bëjnë denoncime. Në Shqipëri, ka ende disa raste ku oficerët e policisë mund të dekurajojnë gratë që të mos raportojnë dhunën në familje. Për rrjedhojë, është e rëndësishme që në Shqipëri po bëhen përpjekje për të përmirësuar reagimin e punonjësve të shëndetësisë, ofruesve të shërbimit, punonjësve të policisë dhe drejtësisë ndaj DhNG-së; ndërkohë, mbetet ende sfidë garantimi i regjistrimit të përshtatshëm të incidenteve të raportuara për dhunën në familje.

Grafiku 1 tregon numrin e rasteve të dhunës në familje të regjistruara nga policia çdo vit që nga viti 2010 deri në 2018 (1 janar – 31 dhjetor). Kini parasysh se shumica e incidenteve të dhunës në familje nuk raportohen ndërsa incidentet që raportohen përbëjnë shpeshherë rastet më serioze të dhunës në familje. Të dhënat tregojë një rritje të vazhdueshme të numrit të rasteve të regjistruara të dhunës në familje, nga 1998 raste në vitin 2010 në 4951 raste në 2018-ën (rritje me 148%). Këto të dhëna tregojnë se viktimat e dhunës në familje janë më të gatshme që të raportojnë në polici rastet e dhunës në familje dhe se policia po regjistron më shumë raste të dhunës në familje. Këto ndryshime mund të lidhen me reformat që janë ndërmarrë gjatë dekadës së fundit për zbatimin e ligjit "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të vitit 2006 si dhe për ndryshimin e normave shoqërore dhe rritjen e ndërgjegjësimit te gratë lidhur me mbrojtjen ligjore dhe shërbimet e disponueshme për viktimat e dhunës në familje.

Grafiku 3. **Kërkesat për urdhra të menjëhershëm mbrojtjeje/urdhra mbrojtjeje (2010-2018)**



Burimi: Policia e Shtetit Shqiptar, janar 2019

Grafiku 4. **Procedimi penal i rasteve të dhunës në familje sipas nenit 130/a të Kodit Penal (2013-2018)**



Burimi: INSTAT, janar 2019

Grafiku 2 paraqet numrin e rasteve të dhunës në familje të raportuara dhe regjistruara në përputhje me nenin 130/a të Kodit Penal, që përfshin akte të tilla si rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune, kanosje ose plagosje të rëndë ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, partner apo ish-parter, fëmijë ose pjesëtar i familjes, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të personit. Të dhënat tregojnë një rritje të numrit të incidenteve të dhunës në familje të regjistruara nga policia sipas nenit 130/a, nga 1169 raste në vitin 2013 në 1699 në 2014-ën (rritje prej 45,3%), pasuar nga një rënie prej 23,5% në 1300 raste në vitin 2015, më pas një rritje prej 14,5% në 1488 raste në 2016 dhe një rënie e lehtë në 1412 raste në vitin 2017.

Grafiku 3 tregon numrin e kërkesave për urdhra të menjëhershëm mbrojtjeje/urdhra mbrojtjeje, të bëra çdo vit nga viti 2010 deri në 2018 (1 janar – 31 dhjetor). Ka pasur një rritje të vazhdueshme të numrit të kërkesave për urdhra të menjëhershëm mbrojtjeje/ urdhra mbrojtjeje nga 1234 në vitin 2010 në 3307 në 2018 (rritje me 146%). Çdo vit nga 2010 deri në 2018, ka pasur një rritje të vazhdueshme në numrin e kërkesave për urdhra të menjëhershëm mbrojtjeje/urdhra mbrojtjeje, me përjashtim të vitit 2015. Çdo vit, u bënë kërkesa për urdhra të menjëhershëm mbrojtjeje/urdhra mbrojtjeje për më shumë se 50% të rasteve të regjistruara të dhunës në familje (shihni grafikun 1); në fakt, në vitin 2018, u lëshuan urdhra të menjëhershëm mbrojtjeje/urdhra mbrojtjeje për 61,3% të rasteve të regjistruara të dhunës në familje (rritje me 53,0% nga viti 2016). Këto të dhëna tregojnë se viktimat e dhunës në familje janë më të gatshme që të përdorin dispozitat e mbrojtjes që parashikohen në ligjin "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të vitit 2006.

Grafiku 4 tregon numrin e rasteve të dhunës në familje të denoncuara dhe ndjekura penalisht sipas nenit 130/a të Kodit Penal. Të dhënat

tregojnë se ka pasur një rritje të numrit të rasteve të dhunës në familje të regjistruara për procedim penal nga prokuroria, nga 826 raste në vitin 2013 në 1215 raste në vitin 2014 (rritje me 47,1%), pasuar nga një rritje nga 1206 raste në vitin 2015 në 1355 raste në 2016 (rritje prej 12,4%), më pas një rënie në 1310 raste në 2017 dhe 1209 në vitin 2018 (rënie me 10,8%). Akoma më pak raste të dhunës në familje u dërguan për gjykim nga gjykatat. Megjithatë, pati një rritje të qëndrueshme të numrit të rasteve të dhunës në familje të dërguara për gjykim nga gjykatat, nga 589 raste në 2013 në 1157 raste në 2016 (rritje me 96,4%), pasuar nga një rënie e qëndrueshme në 1007 raste në vitin 2018 (rënie prej 13,0%). Nuk është e qartë se çfarë e ka shkaktuar këtë rënie të konsiderueshme të numrit të rasteve të dhunës në familje të denoncuara dhe ndjekura penalisht sipas nenit 130/a të Kodit Penal, gjatë periudhës dy vjeçare 2016 - 2018.

Vlen të theksohet se sistemi i drejtësisë penale i mban disa prej autorëve të dhunës në familje në institucionet korrigjuese gjatë kohës që presin për të dalë përpara gjykatës dhe për të marrë vendimin e saj. Në vitin 2016, 196 autorë të dhunës në familje u mbajtën në këto institucione dhe 241 në vitin 2017 dhe 2018 (rritje me 23%).

PSE KËRKOJNË NDIHMË GRATË E RRAHURA NË RASTET E DHUNËS NË FAMILJE?

Gratë e rrahura të cilat kishin kërkuar ndihmë, u pyetën mbi arsyet për të kërkuar ndihmë. Arsyet më të zakonshme të grave të rrahura për të kërkuar ndihmë ishin inkurajimi i marrë nga miqtë ose familja për të kërkuar ndihmë (63,5%), e dinin se dhuna është e papranueshme në marrëdhënie (62,6%), nuk mund ta duronin dot më dhunën (58,8%) dhe ishin lënduar rëndë (43,6%). Edhe pse më të pakta në numër, 22,3% e grave kërkuan ndihmë sepse i shihnin fëmijët e tyre duke vuajtur. Gjithashtu, 9,8% e grave kishin frikë se mos bashkëshorti/partneri do t'i vriste,

Pse kërkojnë ndihmë viktimat e dhunës në familje?

Miqtë ose familja më inkurajuan që të kërkoja ndihmë	63.5%
E di që dhuna është e papranueshme në një marrëdhënie	62.6%
Nuk mund të duroja më tepër dhunë	58.8%
Isha lënduar rëndë	43.6%
Pashë që fëmijët po vuanin	22.3%
Kisha frikë se do të më vriste	9.8%
Më kërcënoi ose u mundua të më vriste	5.9%
Më nxori nga shtëpia	4.7%
Kërcënoi ose goditi fëmijët	4.3%
Kisha frikë se do ta vrisja	2.2%

4,9% raportuan se bashkëshorti/partneri i tyre i kërcënonte se do t'i vriste, 4,7% thanë se bashkëshorti/partneri i kishte nxjerrë nga shtëpia, 4,3% thanë se e kishte kërcënuar ose goditur fëmijët dhe 2,2% kishin frikë se do ta vrisnin bashkëshortin/partnerin e tyre.

Pse largohen nga shtëpia viktimat e dhunës në familje?

Arsyet se pse viktimat e dhunës në familje ishin larguar nga shtëpia herën e fundit	
Nuk mund të duroja dhunë	34.8%
Nuk ndodhi ndonjë incident i veçantë	24.1%
E nxitur nga miqtë/familja	22.9%
Isha lënduar rëndë	13.8%
Më kërcënoi ose u mundua të më vriste	12.4%
Ai kërcënoi se do të godiste fëmijët	12.2%
Kisha frikë se ai do të më vriste	10.4%
Pashë fëmijët duke vuajtur	9.3%
Më nxori jashtë nga shtëpia	4.7%
Kisha frikë se do ta vrisja	0.6%
E nxitur nga organizata	0.0%

A LARGOHEN GRATË NGA SHTËPIA PËR SHKAK TË DHUNËS NË FAMILJE?

Të pakta janë gratë që kanë përjetuar dhunë në familje (10,0% aktualisht, 8,8% ndonjëherë) dhe më konkretisht dhunë fizike dhe/ose seksuale (18,3% aktualisht, 12,1% ndonjëherë), dhe që janë larguar të paktën një herë nga shtëpia për shkak të dhunës në familje, qoftë edhe për një natë. Numri i ditëve gjatë të cilave gratë e rrahura ishin larguar nga shtëpia, luhatet nga 1 në 20 ditë, në varësi të gruas, me një kohë mesatare prej 2,1 ditë për grua.

Ekzistonin një sërë arsyesh për largimin e grave të rrahura nga shtëpia, duke përfshirë: nuk mund ta duronin dhunën (34,8%); ishin inkurajuar nga miqtë apo familja të largoheshin (22,9%); ishin lënduar rëndë (13,8%); bashkëshorti/partneri i kishte kërcënuar se do t'i vriste (12,4%) dhe kishte goditur fëmijët 12,2%; kishin frikë se bashkëshorti/partneri do t'i vriste (10,4%); shihnin fëmijët që vuanin (9,3%); dhe bashkëshorti/partneri i kishte nxjerrë nga shtëpia (4,7%).

PSE NUK KËRKOJNË NDIHMË GRATË PËR DHUNËN NË FAMILJE?

VKDhNG-ja e vitit 2018 zbuloi se shumica e grave që kishin përjetuar dhunë në familje nuk kishin kërkuar ndihmë. Ekzistonin një sërë arsyesh se pse gratë e rrahura nuk kishin kërkuar ndihmë për dhunën në familje. Arsyeja më e zakonshme që dhanë gratë për të mos kërkuar ndihmë ishte se besonin që situata nuk ishte aq e rëndë sa të ankoheshin (47,8%). Edhe pse në një përqindje më të ulët, 12,0% e grave të rrahura thanë se nuk donin të turpëronin familjet, 10,9% ndiheshin në siklet, kishin turp ose frikë se nuk do t'i besonin dhe 9,7% mendonin se do të fajësoheshin ato.

Një përqindje e vogël e grave mendonin se nuk kishte arsye për t'u ankuar pasi dhuna ishte normale (6,8%), kishin frikë nga divorci ose përfundimi i marrëdhënies (6,5%), kishin frikë se mos i kërcënonin dhe nga pasojat e dhunës së mëtejshme (6,1%), kishin frikë se mos humbnin fëmijët (6,0%), nuk dinin ku të kërkonin ndihmë (4,9%) dhe besonin se nuk do të merrnin ndihmë (4,2%).

12.0% e grave të rrahura thanë se nuk donin të turpëronin familjet

Edhe në rastet kur gratë nuk kërkojnë ndihmë për dhunën në familje, shenjat e kësaj dhune janë sërish tepër të pranishme dhe mbeten të fshehura thellë te gratë e rrahura. Për këtë arsye gratë e kanë të vështirë të kërkojnë ndihmë, të shohin opsionet që kanë dhe të organizojnë burimet që nevojiten për t'u larguar nga një martesë/marrëdhënie e dhunshme.

Pse nuk kërkojnë ndihmë gratë për dhunën në familje?	
Situata nuk ishte aq e rëndë sa për t'u ankuar	47.8%
Nuk dua të turpëroj familjen	12.0%
Kam/kisha siklet, turp ose frikë se nuk do të më besonin	10.9%
Mendoj/mendoja se do të më fajësonin mua	9.7%
Mendoj se nuk ka arsye për t'u ankuar/ dhuna është normale	6.8%
Kam/kisha frikë nga divorci ose përfundimi i marrëdhënies	6.5%
Kam/kisha frikë nga kërcënimet dhe nga pasojat ose shtimi i dhunës	6.1%
Kam/kisha frikë se mos humbisja fëmijët	6.0%
Nuk e di/dija se ku të kërkoja ndihmë	4.9%
Mendova se nuk do të më ndihmonin/ Njoh gra të tjera që nuk kanë marrë ndihmë	4.2%

SJELLJET NDIHMË KËRKUESE TË GRAVE NË RASTIN E DHUNËS NGA JOPARTNERI

Ndër gratë e moshës 18-74 vjeç, 18,2% kanë përjetuar "ndonjëherë" dhe 2,4% përjetojnë "aktualisht" dhunë fizike dhe/ose seksuale nga jopartneri që nga mosha 15 vjeçare (nga dikush tjetër përveç bashkëshortit/të dashurit të tyre). Gratë kishin më shumë gjasa të përjetonin dhunë fizike nga jopartneri (17,3%) sesa dhunë seksuale nga jopartneri (1,3%).

Ndër gratë që kishin përjetuar "ndonjëherë" dhunë fizike nga jopartneri që nga mosha 15 vjeç, shumica prej tyre raportuan se autori/ja ishte nëna/njerka (76,1%) dhe/ose babai/njerku (58,0%). Gjithashtu, 35,7% e grave konfirmuan se autori ishte një mësues dhe 28,0% konfirmuan se ishte vëllai ose motra. Gratë identifikuan një sërë dhunuesish të tjerë, por në përqindje më të vogël. Gratë që kishin përjetuar dhunë seksuale nga jopartneri që nga mosha 15 vjeç konfirmuan se autorët ishin: shokë klase/shkolle (15,1%); mësues (7,1%); shokë/të njohur (5,4%); babai/njerku (5,2%); nëna/njerka (4,4%); dhe të panjohur (3,3%).

Ndër gratë që kishin përjetuar ndonjëherë dhunë fizike dhe/ose seksuale nga jopartneri, vetëm 6,6% i kishin treguar ndonjëherë dikujt për dhunën e përjetuar dhe 4,6% kishin kërkuar ndihmë për dhunën nga jopartneri.

NGA KUSH KËRKOJNË NDIHMË GRATË PËR DHUNËN NGA JOPARTNERI?

Shumica e grave, të cilat kishin kërkuar ndihmë për dhunën e pësuar nga jopartneri, kishin kërkuar ndihmë nga familja, përfshirë nga familja e tyre (85,3%), nga familja e bashkëshortit/të dashurit (15,5%) dhe/ose nga ish-bashkëshorti/ish i dashuri (2,6%). Shumë pak gra kërkuan gjithashtu ndihmë nga rrjetet joformale, si fqinjët (16,6%) dhe miqtë (12,1%); vetëm 1,1% e grave kërkuan ndihmë nga udhëheqësit fetarë. Shumë pak gra kërkuan ndihmë nga rrjetet formale, dhe përkatësisht ato kërkuan ndihmë nga policia (8,3%), gjykatat/gjykatësit (4,7%), mjekët/personeli mjekësor (2,6%), avokatët (2,2%) dhe nga një agjenci/organizatë e shërbimeve shoqërore (2,2%).

Nga kush kërkojnë ndihmë gratë për dhunën nga jopartneri?

Familja	
Familja ime	85.3%
Familja e bashkëshortit/të dashurit	15.5%
Bashkëshorti/i dashuri aktual / ish-bashkëshorti/i dashuri	2.6%
Rrjetet joformale	
Fqinjë	16.6%
Miq	12.1%
Udhëheqës fetar	1.1%
Rrjetet formale	
Policia	8.3%
Gjykatat/gjykatësit	4.7%
Mjeku/personeli mjekësor	2.6%
Avokati	2.2%
Agjencia/organizata e shërbimeve shoqërore	2.2%
Strehëza për gratë dhe vajzat	0.0%
Shërbimi i ndihmës	0.0%
Koordinatori lokal për dhunën në familje	0.0%

PSE KËRKOJNË NDIHMË GRATË PËR DHUNËN NGA JOPARTNERI?

Ndër gratë që kërkuan ndihmë, shumica prej tyre kërkuan ndihmë për dhunën nga jopartneri sepse miqtë dhe/ose familjarët i inkurajuan të kërkonin ndihmë (70,8%). Një përqindje e konsiderueshme e grave raportuan gjithashtu se kishin kërkuar ndihmë sepse nuk mund të duronin më dhunën (45,9%) dhe se ishin lënduar rëndë (43,9%). Disa gra kishin kërkuar ndihmë se besonin se ajo që i kishte ndodhur ishte e papranueshme dhe ishte krim (17,4%), sepse burri që kishte ushtruar dhunë, i kërcënonte familjen (3,5%) dhe/ose kërcënonte se do t'i vriste ose ishte përpjekur t'i vriste (2,2%).

Pse kërkojnë ndihmë gratë për dhunën nga jopartneri?

Miqtë ose familja më inkurajuan që të kërkoja ndihmë	70.8%
Nuk mund të duroja më tepër dhunë	45.9%
Isha lënduar rëndë	43.9%
Ajo që më ndodhi mua ishte e papranueshme, ishte krim	17.4%
Burri që ma bëri këtë, kërcënoi familjen time	3.5%
Kisha frikë se burri që ma bëri këtë do të më vriste	2.2%
Kisha frikë se burri që ma bëri këtë do të më vriste	0.0%
Të tjerë	22.4

PSE NUK KËRKOJNË NDIHMË GRATË PËR DHUNËN NGA JOPARTNERI?

VKDhNG-ja e vitit 2018 zbuloi se shumica e grave që kishin përjetuar dhunë nga jopartneri nuk kishin kërkuar ndihmë. Arsyeja më e zakonshme për të mos kërkuar ndihmë ishte se besonin që situata nuk ishte aq e rëndë sa të ankoheshin (38,1%). Disa prej të intervistuarave raportuan gjithashtu se nuk kishin kërkuar ndihmë sepse nuk donin të turpëronin familjen (10,9%), mendonin se do të fajësoheshin (9,6%) dhe ndiheshin në siklet, kishin turp ose frikë se nuk do t'i besonin (9,0%). Disa gra raportuan madje se nuk ka arsye për t'u ankuar se dhuna është normale (7,0%), nuk e dinin ku të drejtoheshin për ndihmë (4,9%), dhe sepse se nuk do të gjenin zgjidhje (2,7%).

Pse nuk kërkojnë ndihmë gratë për dhunën nga jopartneri?

Situata nuk ishte aq e rëndë sa për t'u ankuar	38.1%
Nuk dua të turpëroj familjen	10.9%
Mendoj/mendoja se do të më fajësonin mua	9.6%
Kam/kisha siklet, turp ose frikë se nuk do të më besonin	9.0%
Mendoj se nuk ka arsye për t'u ankuar/ dhuna është normale	7.0%
Nuk e di/dija se ku të kërkoja ndihmë	4.9%
Kam/kisha frikë se do të kërcënohesha, nga pasojat e dhunës së shtuar	3.0%
Mendoja se nuk do të më ndihmonin/ Njoh gra të tjera që nuk kanë marrë ndihmë	2.7%
Kam/kisha frikë se marrëdhënia do të përfundonte	1.5%

RRUGA PËRPARA

Ky ishte studimi i tretë për DhNG-në në Shqipëri, i realizuar nga INSTAT, dhe mund të shërbejë për të informuar masat dhe reagimet e politikave në terren. Gjetjet e vrojtimit të VKDhNG-së për vitin 2018 tregojnë se një numër i vogël i grave kërkojnë ndihmë për dhunën në familje nga partneri intim dhe dhunën nga jopartneri. Ashpërsia e dhunës, qëndrimet ndaj dhunës në familje dhe treguesit e fuqizimit janë faktorë me ndikim në probabilitetin e grave për të kërkuar ndihmë.

Edhe pse ofrimi i shërbimeve formale është i rëndësishëm, politikat e hartuara për të ndihmuar gratë që janë viktima të dhunës në familje nga partneri intim, dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës me bazë gjinore, duhet të identifikojnë dhe adresojnë barrierat që mund të pengojnë sjelljet ndihmë kërkuese. Duke qenë se shumica e grave që përjetuan dhunë në familje nga partneri intim dhe dhunë nga jopartneri, kërkuan ndihmë nga familja dhe miqtë, është e rëndësishme që individët në këto rrjete të gjera të marrin informacione për dhunën ndaj grave dhe vajzave, legjislacionin që trajton dhunën ndaj grave dhe vajzave dhe për shërbimet mbështetëse me bazë në komunitet për viktimat, në mënyrë që të shtrijnë ndihmën edhe më gjerë dhe t'i përgjigjen në mënyrën e duhur familjes dhe miqve të femrave që përjetojnë dhunë.

Konsideratat e përgjithshme mbi zgjidhet e mundshme për zhvillimin e ndërhyrjeve që lehtësojnë sjelljet ndihmë kërkuese të grave që përjetojnë dhunë nga partneri intim, dhunë në familje dhe forma të tjera të dhunës me bazë gjinore përfshijnë:

- Fuqizimin e politikave, planeve të veprimit dhe strategjive për promovimin e barazisë gjinore, duke përfshirë legjislacionin që mbron të gjitha gratë dhe vajzat nga të gjitha format e DhNG-së, duke përfshirë format e reja ose të identifikuara rishtazi të DhNG-së, të tilla si ngacmimi seksual ose përndjekja, duke përfshirë adresimin e tyre nëpërmjet teknologjive të reja, si dhe format e DhNG-së që nuk raportohen nga gratë në polici, agjencitë e drejtësisë dhe organizatat për mbështetjen e viktimave.
- Në kuadër të Programit të përbashkët global të Kombeve të Bashkuara për shërbimet bazë për gratë dhe vajzat që janë objekt i dhunës, është thelbësore që të krijohet një partneritet ndërmjet UN Women, UNFPA, OBSH, UNDP dhe UNODC, i cili do të mundësojë akses më të lartë te një grup shërbimesh bazë të koordinuara cilësore shumësektoriale për të gjitha gratë dhe vajzat që përjetojnë dhunë me bazë gjinore, dhe kjo mund të arrihet përmes:

  - Zhvillimit të një kuadri ligjor gjithëpërfshirës që ofron bazë ligjore dhe gjyqësore për të mbijetuarat e DhNG-së që kërkojnë ndihmë, shërbime shoqërore, shërbime të policisë dhe drejtësisë.
  - Përcaktimit të organizimit, mbikëqyrjes dhe llogaridhënies, për të garantuar përmbushjen e detyrave të qeverisë për të ofruar shërbime cilësore bazë për të mbijetuarat e DhNG-së, si dhe burimet dhe financimet e nevojshme për të ndërtuar dhe mbështetur çdo sektor, së bashku me një sistem të integruar dhe të koordinuar, i cili ka kapacitetet dhe mundësitë për të ofruar shërbime cilësore bazë dhe që mund t'i përgjigjet me efikasitet dhe efektivitet DhNG-së dhe nevojave të të mbijetuarave të DhNG-së.

- Investimeve në trajnime dhe zhvillimit të fuqisë punëtore për të garantuar që agjencitë në sektor dhe mekanizmat e koordinimit kanë kapacitetet për të ofruar shërbime cilësore dhe se ofruesit e shërbimeve kanë kompetencat për të përmbushur rolet dhe përgjegjësitë e tyre.
- Përcaktimit të praktikave për monitorimin dhe vlerësimin periodik të shërbimeve bazë për të mbijetuarat e DhNG-së; për ta bërë këtë nevojitet fuqizimi i mbledhjes së të dhënave administrative dhe analizimi dhe publikimi i këtyre të dhënave në mënyrë që të përdoren për të monitoruar aksesin në shërbimet bazë dhe për të nxitur ofrimin e shërbimeve cilësore.
- Zhvillimit të politikave në çdo sektor dhe i mekanizmave koordinues, të cilat përmirësojnë qasjet e bazuara tek të drejtat dhe të fokusuara te viktimat dhe që janë të përshtatshme në aspektin gjinor dhe të moshës, të ndjeshme dhe promovojnë barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, sigurinë e tyre, si një element me rëndësi thelbësore, dhe llogaridhënien e autorëve.
- Ofrimit të të gjithë shërbimeve bazë dhe masave me karakteristikat në vijim: disponueshmëri dhe aksesueshmëri; përshtatshmëri; prioritizojnë sigurinë; pëlqim të informuar dhe konfidencialitet; komunikim efikas dhe pjesëmarrje e grupeve të interesit në hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e shërbimeve; kanë sisteme informacioni dhe të mbledhjes së të dhënave; dhe lidhje me sektorët dhe agjencitë e tjera përmes koordinimit.
- Zhvillimin e fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit dhe ndryshimin e sjelljes ndaj DhNG-së, në të gjitha format, dhe korrigjimin e informacioneve të gabuara dhe stereotipeve që lidhen me dhunën në familje nga partneri intim, dhunën në familje, përdhunimin/sulmin seksual, ngacmimin seksual dhe përndjekjen. Këto fushata duhet të inkurajojnë të mbijetuarat e DhNG-së që të njohin të drejtat e tyre dhe të kërkojnë ndihmë në rastet e DhNG-së, si dhe të ndajnë histori të vërteta të të mbijetuarave të DhNG-së, të cilat kanë kërkuar ndihmë dhe kanë përfituar nga ndihma. Duhet të bëhen përpjekje të veçanta për të zhvilluar fushata të rritjes së ndërgjegjësimit dhe ndryshimit të sjelljes ndaj DhNG-së që synojnë dhe i drejtohen në një mënyrë të dobishme shumicës së grupeve të marxhinalizuara të grave dhe vajzave në Shqipëri, si romët dhe egjiptianët, gratë me aftësi të kufizuara, gratë nga zona të izoluara, gratë e moshuara si dhe personat lesbike, biseksuale dhe transgjinore.
- Për të zhvilluar masat dhe reagimet e politikave në terren, aktorët e shoqërisë civile që punojnë me të mbijetuarat e DhNG-së dhe vetë të mbijetuarat e DhNG-së duhet të përfshihen në këto veprimtari për të garantuar se rezultatet praktike për të mbijetuarat e DhNG-së janë efikase dhe të qëndrueshme. Angazhimi i të gjithë qeverisë në sektorët të ndryshëm dhe të të gjithë shoqërisë për të ndryshuar normat shoqërore që lidhen me DhNG-në dhe për të përmirësuar aksesin në shërbimet bazë si dhe reagimet në sistemin e policisë dhe drejtësisë.
- Të gjithë autoritetet përkatëse publike ligjzbatuese dhe gjyqësore duhet të krijojnë kategori për të dhënat penale dhe administrative për të gjitha

format e DhNG-së dhe të garantojnë harmonizimin e tyre në të gjithë sektorët. Këto lloje të të dhënave administrative duhet të mblidhen në mënyrë periodike, të përpilohen, analizohen dhe raportohen për të informuar autoritetet që formulojnë politika, plane veprimi dhe programe për të eliminuar DhNG-në dhe për të rritur besimin tek të mbijetuarat e DhNG-së me qëllim që ato të raportojnë incidentet e DhNG-së dhe të kërkojnë ndihmë nga autoritetet përkatëse publike dhe ofruesit e shërbimeve.

- Qeveria e Shqipërisë duhet të garantojë mekanizmat e financimit për të mbështetur parandalimin e DhNG-së si dhe programet e ndërhyrjes dhe iniciativat që kontribuojnë në mbrojtjen e grave dhe vajzave nga të gjitha format e dhunës. Në veçanti, financimet nevojiten për ofrimin e shërbimeve cilësore bazë për të mbijetuarat e DhNG-së, si dhe për të rritur ndërgjegjësimin e tyre rreth gamës së shërbimeve mbështetëse të disponueshme për viktimat dhe të drejtave të grave dhe vajzave për mbrojtje nga dhuna.

Ending Violence Against Women